



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punë/Prodot Received/Delivery	12. 01 2021	1	viti god year
Organ /Rrjeta Org./Jednica Org./Unit	Rr. Prot Rr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/HCV	105/2021		1/6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.115/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bektoshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.115/2020 të datës 08.04.2020 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë rruga “Egnatja”, Hyrja 13, Nr. 21 në Ulpianë-Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.Prot:2779 të datës 09.03.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit në çështjen juridike “*ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.01.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.115/2020 e datës 08.04.2020 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.Prot:2779 të datës 09.03.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit dhe Vendimi me Nr. Prot:699 i datës 23.01.2020 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.
- III. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimt të tij, duke e kthyer ankuesin Mirdit Emini në pozitën “Koordinator për të Drejtat e Njeriut” sipas akt emërimit, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës dhe duke bërë kompensimin e pagës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ndaj ankuesit \_\_\_\_\_ punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës, më datë 27.11.2019 në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës është iniciuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor. Më datë 27.11.2019 kjo kërkesë i është përcjell edhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit më datë 23.01.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. Port: 699 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës". Kundër këtij vendimi ankuesi më datë 21.02.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Ambientit më datë 09.03.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. Port: 2779 me të cili ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. Port: 2779 të datës 09.03.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Ambientit, më datë 08.04.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 713/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.05.2010, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Infrastrukturës. Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit më datë 26.05.2020 ka përcjell në Këshilli përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritot ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 713/2020 të datës 08.04.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 10.03.2020 nga ankuesi; Kërkesë e datës 05.03.2020 nga ankuesi; Kërkesë e datës 06.03.2020 nga ankuesi; Vendimin me Nr. Prot:2779 i datës 09.03.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit; Ankesë e datës 21.02.2020 nga ankuesi për Komisionin e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me Nr. Prot:1000 i datës 27.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Vendimin me Nr. prot:699 i datës 23.01.2020 i Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Procesverbal i datës 20.12.2019; Mesazh telefoni; Vendimin e datës 26.03.2018; Vertejt e dyte e datës 24.09.2019 për ankuesin; E-mail i datës 23.09.2019; E-mail i datës 19.09.2019; E-mail i datës 27.11.20219 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; E-mailin e datës 27.11.2020 nga \_\_\_\_\_; E-mailin e datës 27.11.2019 nga ankuesi; Vendim për zgjatje të afatit i datës 26.12.2019; Procesverbal i datës 22.01.2020, 10.01.2020, 14.01.2020 i Komisionit Disiplinor; Vendim i datës 27.11.2019; Ankese e datës 26.09.2019 dhe 18.07.2019 nga ankuesi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 18.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Vendim i datës 12.02.2019 dhe 21.12.2018 i Sekretarit të Përgjithshëm; Akt Emërim i ankuesit 17.01.2012; Përshkrim i detyrave të punës; E-mail i datës 27.11.2019 nga \_\_\_\_\_ Kërkesë e datës 27.11.2019 për iniciimin e procedurës disiplinore; Njoftim lidhur me vendimin i datës 23.01.2020; Fletëdorëzim i datës 27.01.2020; Kërkesë e datës 12.05.2020 nga ankuesi; E-mail i datës 21.02.2020 nga \_\_\_\_\_ Informim për iniciimin e procedurës disiplinore datë 04.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës për rastin ka vendosje jashtë afatit ligjor në kundërshtim me legjislacion në fuqi sepse shtyrja e afatit për vendosje në kundërshtim me legjislacion në fuqi; Ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës konstaton se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë më datë 27.11.2020, ndërsa më datë 26.12.2019 është nxjerr vendim për zgjatje të afatit për rastin e ankuesit me arsyetimin se: *"...si kryesues i komisionit kam qenë i angazhuar çdo ditë të javës me kërkesa për transfere/ridestinine të mjeteve, përgatitje të kërkesave për zotim të mjeteve, si dhe përgatitje të lëndëve për pagesë për projektet kapitale të MIT-së..."*, ndërsa Komisioni Disiplinor më datë 23.01.2020 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot 699 lidhur me rastin e ankuesit, mbi bazë të kësaj në pajtim me nenin 135 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se: *"Përpos kur ligji parashih një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës"*, mirëpo përkundër këtij afati sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet që: *"Afati i paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shtyhet kur nevojiten shqyrtime administrative shtesë. Neni 99 i këtij Ligji do të zbatohet përshtatshëmrisht gjithashtu për shtyrjen e afatit të paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni"*, ndërlidhur me neni 99 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar që: *"Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji"*, rrjedhimisht pretendimet për shtyrje të afatit për vendosje lidhur me kërkesën për procedurën disiplinore ndaj ankuesit nuk janë vendimtare dhe nuk kanë asgjë të bëjë me lëndës sepse shtyrja mund të bëhet vetëm kur kemi të bëjmë me kompleksitet të çështje, ndërsa nuk janë dhënë arsye se çështja është komplekse, kësaj shtyrja e afatit për vendosje është në kundërshtim me nenet e lartcekura.

Bazuar në atë që u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor ka qenë i obliguar që lidhur me kërkesën e datës 27.11.2019 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit të vendos brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh siç parashihet me nenin 135 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se: *"Përpos kur ligji parashih një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës"* dhe nenin 14 paragrafin 3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"...komisioni duhet të marrë vendim brenda tridhjetë (30) ditëve prej lajmërimit të rastit"*. Rrjedhimisht çdo akt administrativ i nxjerr në kundërshtim me procedurën ligjore dhe është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative është akt administrativ i paligjshëm siç parashihet me nenin 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në të gjitha provat e lëndës konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit me Vendimin me Nr. Prot:699 të datës 23.01.2020 me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës", ka dhënë arsye se ndaj ankuesit janë shqiptuar disa herë masa disiplinore. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, referuar këtij arsyetimi, konstaton se ankuesit më datë 24.09.2019 i është shqiptuar vërejtja e dytë nga znj. Vahide Sylja pas e-amilit të datës 23.09.2019 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, rrjedhimisht Rregullorja Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ka paraparë se kush mund të shqiptoj masa disiplinore ndaj nëpunësve civil respektivisht me nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civilë, parashihet që: *"vërejtja me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë shqiptohet në proporcion me pasojat e shkaktuar dhe vendoset në dosjen personale të nëpunësit civil",* në këtë kuptim znj. nuk është mbikëqyrëse e drejtpërdrejt e ankuesit dhe nuk ka kompetencë të shqiptoj masa disiplinore për nëpunësit që nuk janë vartës të saj, kështu që çdo akt i nxjerr nga personi që nuk ka kompetencë është në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj bazuar në këtë Komisioni Disiplinor i Ministrisë së infrastrukturës dhe Transportit gabimisht ka aplikuar gjendjen faktike duke aplikuar gabimisht edhe ligjin material në dëm të ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot:699 të datës 23.01.2020, nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë faktet dhe provat vendimtare që kanë të bëjnë me rastin e ankuesit sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shqiptimin e masës së tillë disiplinore, sepse masat disiplinore shqiptohen duke u bazuar në fakte ligjore siç përcaktohet me nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve",* po ashtu masat disiplinore duhet që të shqiptohen në proporcion me shkeljen siç parashihet me nenin neni 66 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil".*

Rrjedhimisht mbi bazë të të gjitha të lartcekurave Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse Vendimin me Nr. Prot:699 i datës 23.01.2020 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit është i paqartë dhe kundërthënës dhe është në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij",* kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot:2779 të datës 09.03.2020 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil

të Republikës së Kosovës Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në pozitën "Koordinator për të Drejtat e Njeriut" sipas akt emërimit, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës dhe duke bërë kompensimin e pagës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional, ndërsa pas zgjedhjes së pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrtimit të bazës ligjore, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e katërt të mbajtur më datë 09.11.2020 nxjerr Vendim me Nr. 9/2020 me të cilin është vendosur që të gjitha ankesat e dorëzuara dhe ato të kthyer në rishqyrtim nga gjykata do të vendosen nga Këshilli.

Secila palë që ka mundur të hap konflikt administrativ si pasoj e mos veprimit të KPMSHCK-së duhet të veproj konform dispozitës së shënuar më poshtë të Ligjit për Konfliktin Administrativ i cili përcakton si vijon: Neni 36 1. *Nëse organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin nga neni 29 i këtij ligji nxjerr më vonë aktin administrativ, ky organ, përpos paditësit, do ta njoftojë edhe gjykatën. 2. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklarohet nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm: 2.1. është i kënaqur; 2.2. nuk heq dorë nga padia; 2.3. pjesërisht heq dorë nga padia; 2.4. ai/ajo padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër. 3. Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk e jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 2. i këtij neni, gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës. 4. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është ai/ajo i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh



nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.115/2020

Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

